



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 199/6 Prot.

Datë 09.02.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 165 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2024 me

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt “Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet”, me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERJISË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipër cituar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK,  
me NIPT: L81506043D, dhe Adresë: Rr. “*Idriz Dollaku*”,  
Apartamenti 2, shk, 1, kati i I, L. Ali Demi, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** BURSA SHQIPTARE E ENERJISË ELEKTRIKE SH.A -  
ALPEX.  
Adresa: Rr. “*Liman Kaba*”, Rezidenca Olympic, Shkalla 3,  
Kati 1, Zyra nr.1, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.01.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt “Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet”, me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERGIJË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2024/3775, datë 28.01.2024, dhe me

nr. 199/2024 prot., datë 29.01.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet informacionit të ardhur në sistem, me shkresën nr. 45/6 prot., datë 02.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 199/2 prot., datë 02.02.2024, dhe me shkresën ardhur me postë me nr.45/7 prot., datë 02.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 199/3, datë 05.02.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik “Informacion” nga autoriteti kontraktor.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK dhe me Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, ka vendosur pranimin pjesërisht të saj në lidhje me ndryshime në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

Operatori ekonomik ka kërkuar ndryshime në *Shtojcën 8 “Formulari i Kritereve për Kualifikim, 2.3. Kapaciteti Teknik, pika 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrimit të AKEP, për ofrimin e shërbimit dhe për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë dokumentin përkatës/licencën e shoqërisë.*

III.1.1. Autoriteti Kontraktor ka pranuar pretendimet e ankimuesit për këtë pikë të ankesës duke sqaruar se:

*[...] duke qenë se ky kriter nuk është shprehur qartë (bazuar në ankesë) dhe mund të shkaktojë konfuzion tek pjesëmarrësit, KSHA bie dakord që kjo kërkesë e Kritereve të Veçanta të hiqet.*

*Për sa u përket, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës,*

*Vendosi:*

- 1. Pranimi i Pjesëshëm i ankesës së operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK*
- 2. Vendimi i dërgohet K.P.P-së dhe operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK*
- 3. Pezullimin e procedures së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet”, të ALPEX.Sha, deri në marrjen e vendimit të KPP-së.*

III.1.2. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, vendos të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK, për modifikim të DST për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt “Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet”, me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

Operatori ekonomik ka kërkuar: *ndryshime në Shtojcën 8 “Formulari i Kritereve për Kualifim, 2.3. Kapaciteti Teknik,*

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të disponojë AS Number dhe të ofrojë route për AS Number protokollit BGP. Operatori ekonomik duhet të disponojë AS të regjistruar pranë RIPE NCC dhe të paraqesë vërtetimin përkatës për këtë.*

*“Lidhur me kriterin më sipër, autoriteti kontraktor e zgjeron akoma më shumë kërkesën e tij duke detyruar operatorët ekonomik që përveç regjistrimit pranë AKEP, i cili është një institucion shqiptar dhe funksionimin e tij e ka mbi bazën e legjislacionit shqiptar, të jetë i regjistruar në një institucion ndërkombëtar siç është RIPE NCC.*

*Por çfarë garancie ekonomike, teknike dhe profesionale kërkon autoriteti kontraktor të sigurojë lidhur me operatoret ekonomikë, gjithmonë mbi bazën e objektit të prokurimit? Nisur nga lista e operatorëve ekonomik të cituar në pikën e parë, theksojmë se vetëm 1 prej tyre është i regjistruar në sistemin RIPE NCC. Regjistrim i cili nuk ka lidhje për krijimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web por me rrjetin e telekomunikacionit ku është i detyrueshëm licencimi përkatës.*

*Radhitur sipas kritereve na rezulton që autoriteti kontraktor ose ka vendosur kritere duke bërë lapsus lidhur me objektin e prokurimit ose në të kundër që ne si operatorë ekonomik e kemi të vështirë ta besojmë se ka dashur të pengojë pjesëmarrjen e operatorëve serioze ekonomik duke e paracaktuar këtë tender pasi vetëm 1 operator ekonomik plotëson pikën 2.3.5.”*

III.2.1 Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST, shtojcën 8, Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit , pika 2.3.5 si vijon:

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të disponojë AS Number dhe të ofrojë route për AS Number protokollit BGP. Operatori ekonomik duhet të disponojë AS të regjistruar pranë RIPE NCC dhe të paraqesë vërtetimin përkatës për këtë.*

Referuar Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim:

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 2, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për më tej ky kriter bën të mundur një koordinim administrativ dhe teknik të nevojshëm për të mundësuar funksionimin dhe aksesin e vazhdueshëm të shërbimeve të kërkuara nga AK.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.3. Në nenin 77, pika 1, 2 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.4. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pikat 1, 2, 4/a, 6 dhe 7, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.
2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.
4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
  - a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.
7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj

dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, e konkretisht kthim - përgjigjes drejtuar ankimesit, KSHA lidhur me pretendimin për heqje të kriterit 2.3.5 argumenton:

*[...] një ndër elementët që kërkon procedura është edhe hostimi i faqes së AK-së, Regjistrimi i AS në RIPE NCC garanton që OE zotëron infrastrukturën e tij të hostimit si edhe është në një linjë me kërkesat e AK-së, përse i përket hostimit dhe garanton menaxhimin e route.*

*Ankesa nuk pranohet për këtë pikë. [...]*

Referuar Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor argumenton si vijon:

*Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 2, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për më tej ky kriter bën të mundur një koordinim administrativ dhe teknik të nevojshëm për të mundur funksionimin dhe aksesin e vazhdueshëm të shërbimeve të kërkuara nga AK.*

Komisioni referuar dokumentacionit të procedurës vëren, se autoriteti kontraktor vendosjen e kriterit kualifikues pika 2.3.5 nuk e ka argumentuar qartë, se përse është e nevojshme pajisja me **AS number të regjistruar pranë RIPE NCC** nga operatorët ekonomikë, ku konsiston kjo kërkesë si edhe lidhjen e saj me objektin e prokurimit.

Në rastin konkret, Komisioni thekson, se operatorët ekonomikë duhet të krijojnë besimin e duhur për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, i cili duhet të jetë sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në termat e referencës dhe kriteret për kualifikim, si dhe duhet të krijojnë siguri dhe garanci për cilësinë e tyre.

Referuar termave të referencës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për pajisje me **AS number të regjistruar pranë RIPE NCC** është një kërkesë jo në proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit.

Gjithashtu referuar dokumenteve të dosjes, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të dëshmojë se si disponueshmëria e një kërkesë të tillë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe arritjes së synimit të kërkuar.

Në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet, se *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”*

Sa më sipër, qëllimi ( ratio legis) i ligjvënësit është që kriteret e veçanta për kualifikim, veçanërisht ato që lidhen me aftësitë teknike, duhet të vendosen që të garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën sipas një standardi të posaçëm cilësie.

Akoma më tej, Komisioni vëren, se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST në pikën 2.3.2, që OE të ketë staf prej 3 inxhinierësh me kërkesat si vijon:

*Operatori Ekonomik gjithashtu duhet të vërtetojë njohurinë e stafit përgjegjës për:*

- *sigurinë në internet*
- *shërbimet e dizanjit dhe photoshop*
- *shërbimet e serverave.*

***Për të vërtetuar këtë, operatori duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të këtyre personave. Një person mund të ketë një ose më shumë certifikime.***

Gjithashtu, edhe në pikën 2.3.3, *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*

- *ISO 9001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë*
- *ISO 27001: për menaxhimin e sigurisë së informacionit,*

Referuar kriterëve sipër cituar, Komisioni konkludon, se këto dy kriterë janë mëse të mjaftueshme në një procedurë të hapur të thjeshtuar, për të përmbushur shërbimin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se hartimi i kriterëve kualifikuese të paargumentuara dhe joproporcionale me objektin e prokurimit, llojin e procedurës, fondin limit, ngarkojnë operatorët ekonomikë me kërkesa të tepërta dhe kufizojnë pjesmarrjen e tyre në procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetin kontraktor, si organ përgjegjës për procedurën e prokurimit, ka detyrë të përcaktojë kriterë që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë dhe specifikime teknike në lidhje me shërbimet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion, apo që nuk ndikojnë në performancën e shërbimit të kërkuar, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment, autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriterë të cilat janë përjashtuese për operatorët, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik.

Në kushtet kur në kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor, lidhur me këtë pretendim të ankimuesit, nuk ka dhënë asnjë argument bindës që të kundërshtojë këtë pretendim, Komisioni gjykon, se Autoriteti Kontraktor duhet të modifikojë kriteret për kualifikim, duke hequr kriterin 2.3.5, me qëllim që të rrisë pjesmarrjen dhe të hapë konkurrencën e operatorëve ekonomikë, në garën për të fituar kontratën e shpallur.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INSTANT.AL” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të



Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-93765-01-25-2024, me objekt “Mirëmbajtje e Web dhe shërbim për dy vjet”, me fond limit: 1.800.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.02.2024, nga autoriteti kontraktor, BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A - ALPEX.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, për modifikim të dokumenteve të procedurës së prokurimit sipër cituar.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

